



Diel, 21 Shkurt 2010 09:05:38



Lexoni versionin Print

HOME POLITIKE KRONIKE BIZNES SHOQERI EDUKIMI KULTURE SHENDETI RAJONI KOMENTE MENDIMI JUAJ SPORT

Kontakt | Reportazh | Dossier | Podcast | Shekulli TV | Foto | RSS | Punesime | Auto | PDF | Mobile | Arkivi | Shekulli Blog | Horoskopi

GAZETA PRINT

Dr.Laura, një nga 4 kozmologet femra në botë, është shqiptare..!

Gjatë punës si gazetar shpesh me krijohet mundësia për të takuar njerëz interesantë dhe të veçantë, por personazhi i sotëm i cili do të jetë i ftuar në rubrikën tonë intervista do të jetë tejet specifik. Kjo për shkak të profesionit të saj.

Nazim Rashidi *

Shtune, 19 Prill 2008 09:32:00

Gjatë punës si gazetar shpesh me krijohet mundësia për të takuar njerëz interesantë dhe të veçantë, por personazhi i sotëm i cili do të jetë i ftuar në rubrikën tonë intervista do të jetë tejet specifik. Kjo për shkak të profesionit të saj. Ajo është kosmologe, një profesion tejet i rrallë në të gjithë botën, ndërkohë është e vetnja shqiptare me një profesion të tillë dhe një nga shumë pak femrat në të gjithë botën që merren me këtë shkencë.

Laura Mersini Houghton jeton në SHBA dhe në komunitetin e shkencëtarëve botërorë është e njohur për teoritë e saj për kozmosin dhe krijimin e gjithësisë, ka sfiduar teorinë e Ainshtanjit, për të cilën ka marrë vlerësime ndërkombëtare, por në Shqipëri thuhet nuk është e njohur fare.

BBC - Laura si do ta prezantoje veten?

Laura Mersini - Unë punoj si profesoreshë asistente në Universitetin e North Caroline në Chapel Hill. Fusha ime e specializimit është fizika teorike dhe kozmologjia. Studimet e para i bëra në Shqipëri, ndërsa master, doktoraturë dhe post doktoraturë në Amerikë.

Profesioni juaj është kozmologe. Çfarë në fakt nënkupton ky term?

Në këtë moment, përfshin shumicën e fizikës teorike. Ka të bëjë me studimin e universit në tërësi dhe me historinë e universit që nga koha e Big Bang, si fillojë universi dhe deri në universin e kohës së tanishme.

Laura, unë di që ju keni kryer studimet në Shqipëri për fizikë. Përse vendosët të merreshit me kozmosin?

Kjo fushë është shumë interesante për çdo student që bën doktoraturën në fizikë. Është fushë shumë e vështirë dhe kjo është një nga arsytet përse jo shumë veta punojnë në këtë fushë. Pra, intriga ishte aty dhe unë vendosa ta vazhdoj deri në fund këtë kuriozitet.

Pak më herët, unë thashë se nuk ju njohin shumë njerëz këtu në Shqipëri, përse ndodh kjo?



Maqedoni, liderët e partive në takim për zgjedhjet e marsit

09/01/09 08:22:00 | Katër partitë më të mëdha politike në Maqedoni sot do të..

Një tërmet 4.5 ballë bie në Maqedoni, ndjehet edhe në Tiranë. S'ka dëme

08/01/09 17:17:00 | Një tërmet me fuqi rreth 4,5 ballë sipas shkallës Rihter goditi..

LAJME TE NGJASHME

- Zyrtarët borxhlinj te taksat, heshtje fajtores - data/09-01-2009
- Gëzuar me ashure - data/09-01-2009
- Legalizimi i dokumenteve në ambasadën greke, tani me postë - data/06-01-2009
- Teleskopi mbush 400 vjeç - data/05-01-2009

LAJMET E FUNDIT

- Policia aksion në Kakome, arreston 15 vetë, i hapet rruga ndërtimit të fshatit turistik - data/09-01-2009
- "Tim bir e vrau Dondollaku", dëshmon babai i Nimet Zenelit - data/09-01-2009
- Akulli, të moshuarit në spital me frakturë - data/09-01-2009
- Alkooli dhe moti i ftohtë i marrin jetën 41-vjeçarit - data/09-01-2009
- Monopoli në tregun e hidrokarbureve, Rama: Qeveria të gjejë zgjidhje - data/09-01-2009
- Durrës, maskat hyjnë në një shtëpi, përleshen me familjarët

15 shqiptarët më të famshëm të SHBA

1

Anthony Athanas (lindur më 1911 në Korçë). Shkoi në Nju Jork kur ishte vetëm 5 vjeç dhe arriti të hapte në Boston një nga restorantet më të njohur të vendit.

Vitet e fundit, restoranti i tij shërbente afërsisht 700,000 vakte në vit, duke u konsideruar si restoranti i pestë më të rëndësishëm në Amerikë.

Bostoni është qyteti ku jeton numri më i madh i emigrantëve shqiptarë në SHBA.

2

Florin Krasniqi ka lindur më 1964 në Kosovë. Është një biznesmen i suksesshëm në Amerikë. Në vitet e krizës së Kosovës ai mbledhi 30 milionë dollarë nga komuniteti shqiptar në SHBA dhe më pas i ofroi si ndihma për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Florin Krasniqi udhëton shpesh në Kosovë. Projekti i fundit është ndërtimi i një hidrocentrali.

3

Stan Dragoti është drejtor filmash, i njohur më shumë për komeditë e tij të 1980 "Mr. Mom!" dhe "The Man With One Red Shoe". Stan Dragoti është lindur në Nju Jork nga prindër shqiptarë. Vetëm pak muaj më parë ai vizitoi Tiranën, ku mori përsipër një projekt për ndryshimin e imazhit të shqiptarëve në botë.

4

Billi Kovaçi lindi më 1932 në Tenesin Lindor, nga prindër shqiptarë. Ai është një gazetar amerikan dhe ka mbajtur pozicione kryesore në gazeta si: "The New York Times", "Atlanta Journal-Constitution", dhe bashkëautor i librit mjaft popullor "Elementët e gazetarisë: Çfarë duhet të dinë njerëzit e lajmeve dhe çfarë duhet të presë publiku". Ka themeluar një shoqatë me emrin Komiteti i Gazetarëve, në SHBA.

5

Agim Kaba lindi më 16 shkurt të vitit 1980 në Nju Jork. Është një aktor amerikan. Pas shkollës së mesme ai është diplomuar për arte të bukura. Ndërkohë Agimi është duke luajtur rolin e Aaron Snyder në serinë amerikane "As the World Turns" dhe është kandiduar për çmimin "Emmy". Emri i tij përkthehet shpeshherë nga mediat si "lindja e diellit". Kaba ka luajtur gjithashtu në një episod të Charmed.

6

Masiela Lusha lindi më 23 tetor 1985 në Tiranë, Shqipëri. Ajo është një aktore shqiptare-amerikane nga ShBA. Familja e saj ka emigruar në Shtetet e Bashkuara kur ajo ishte 7 vjet. Kur ishte 12 vjeç, ajo publikoi një libër me poezi, në dy gjuhë, Shqip dhe Anglisht. Ajo u bë aktore dhe luajti Carmen te seria "ABC The George Lopez Show" me George Lopez. Masiela ka luajtur gjithashtu edhe në filmin Summoning dhe Cherry Bomb. Shumica e adhuruesëve të saj mendojnë që ajo është spanjolle, për shkak të rolit që ajo luan në serialin "The George Lopez Show", por ajo është një shqiptare-amerikane.

7

Gjeke Marinaj është një shkrimtar shqiptaro- amerikan. Lindur në Malësinë e Madhe më 1965, Gjeke Marinaj studjoi gazetari në Vlora dhe publikoi artikullin e parë në moshën 16 vjeçare. Në mesin e viteve 20, ai botoi një poemë anti- komuniste të quajtur "Kuajt" në gazetën Drita. Kjo poemë ishte dhe shkak për ai u detyrua të arratisë nga Shqipëri, duke kaluar përmes maleve në Jugosllavi, e më vonë do të emigronte në SHBA.

8

Eliza Dushku lindi më 30 dhjetor 1980 në Boston, Massachusetts. Është një aktore amerikane me prejardhje nga një familje shqiptaro-daneze. U bë e njohur me rolin Faith në TV serinë Buffy dhe nga TV seria Angel. Prindrit e Elizës janë profesorë universiteti, babai është shqiptar nga Korça ndërsa nëna daneze dhe jep mësim në universitetin e Suffolk-ut në Boston. Filloi karrierën e saj në moshën 10 vjeçare në filmin "That Night", të cilën e pasuroi duke luajtur së bashku me disa yje të filmit amerikanë si :Robert de Niro, Ellen Barkin, Leonardo DiCaprio, Arnold Schëarzenegger, Jamie Lee Curtis, Halle Berry dhe James Belushi.

9

Ferid Murati lindi më 14 shtator të vitit 1936 në Ëhiting, Indiana, SHBA nga Xhabir Murad Ejupi (i ati shqiptar) dhe Henrieta Boëman (e ëma amerikane). Ai është diplomuar në Universitetin e Virxhinias, ku gjithashtu u emërua profesor në vitin 1970. Aty ka punuar deri në vitin 1981 para se të zhvendosej në Stanford.

Studimet e tij janë përqëndruar në efektin e nitroglicerinës në trupin e njeriut. Ai ka punuar mbi këtë temë për vite të tëra bashkë me Robert Furchgott dhe Louis Ignarro. Të tre bashkë fituan çmimin Nobel në 1998. Ferid Muratit i dedikohet shpikja e Viagras, tashmë me famë në të gjithë botën.

10

James Belushi, lindi më 15 qershor të vitit 1954 në Çikago (Illinois), është aktor i kinematografisë, teatrit dhe televizionit në SHBA me prejardhje shqiptare.

Është fëmija i tretë nga katër fëmijët e Adem dhe Agnes Belushit. Babai i tij, Ademi, emigroi në SHBA, duke lënë vendlindjen fshatin Qytezë në vitin 1934 në moshën 15 vjeçare. Ndërsa nëna e tij, Agnes Belushi, lindi në SHBA, bijë e një emigranti shqiptar. Është i famshëm për disa role në filma shumë të njohur hollivudianë.

11

John Belushi lindi më 24 janar 1949 në Çikago, Illinois, ishte aktor dhe këngëtar nga SHBA me prejardhjen shqiptare.

Më 1970 ai luan së bashku me Dan Aykroyd në bendin "The Blues Brothers".

Në mbarë SHBA-të bëhet i njohur kur luan në emisionin televiziv "Saturday Night Live". Ky emision është një nga shkallët e para për shumë aktorë për të hyrë në Hollyëood.

Filmi i parë i John Belushit është Animal House, kurse suksesi i tij më i madh është komedia The Blues Brothers nga regjisori John Landis, ku ai së bashku me Dan Aykroyd bëhet figurë kulti.

Nga përdorimi i gjatë i drogës ai vdes më 1982 në moshën 33 vjeçare dhe lë pas gruan Judy Jacklin.

12

Xhozef DioGuardi apo Joseph J. DioGuardi lindi më 20 shtator të vitit 1940, është politian amerikan me origjinë shqiptare nga Italia. DioGuardi është kongresmen në kongresin e Shteteve Bashkuara të Amerikës.

Sipas DioGuardit ai vjen nga një familje e ushtarëve të Skenderbeut të cilët kishin ndihmuar Mbretërinë e Napolit më 1461.

13

Donald Llambro është një nga gazetarët më të njohur në SHBA. Aktualisht është shef

i korrespondencës politike në gazetën The Ëashington Times. Ai ka lindur në 14 korrik 1940 në Masacusets nga prindër shqiptarë. Është i martuar dhe ka një djalë. Një nga artikujt e tij më të spikatur është zbulimi i disa kundërthënieve në debatin presidencial mes Xhon Kerri dhe Xhorxh Bush.

14

Ekrem Bardha është një nga biznesmenët më të njohur të komunitetit shqiptaro-amerikan. Në moshën 70 vjeç ai është pronar të paktën 18 restoranteve McDonalds në SHBA si dhe i restorant Piacas në Tiranë. Ai, dy vëllezërit e tij dhe nëna janë arratisur nga Shqipëria drejt Greqisë gjatë diktaturës, duke lënë pas një vëlla të burgosur dhe pushkatuar nga rregjimi.

15

Aleks Rudaj është shqiptar nga Mali i Zi, por ndryshe nga të sipërpërmendurit, historia e tij është ajo e një gangsteri të pasur të akuzuar nga policia dhe FBI për një numër krimesh. Emri i Rudajt lidhet me aktivitetet në disa zona të njohura të Nju Jorkut për veprimtari ilegale si Bronx dhe Queens. Aktualisht Rudaj është dënuar me 27 vjet burg në SHBA

Përgatiti Elona Demollari

POSTO NE:

 digg it  Yahoo MyWeb  Google  Slashdot  del.icio.us  Technorati

Emri juaj:

E-mail juaj:

Titulli:

Komenti juaj:

RmTpw

Reklama ne Shekulli Online

Tel: 042256994
Fax: 042256015
Cel: 0692187272
E-Mail: reklamashekulli@yahoo.com

© 1997 - 2008 shekulli.com.al | Biznesi Online | Sporti Shqiptar | Revista Speker | Botimet Max | Arti i Kuzhines | Arkivi |

© 2008 Te gjitha te drejtat Shekulli | Kontakt | Staf Online  Lidhja RSS/XML